



REPUBLIKA E SHQIPËRISE
BASHKIA BERAT

Nr. 2989 prot

Berat, me 13.09 2019

Lenda: Dergohet dokumenti i fazes se rishikuar te Programit Buxhetor Afatmesem 2020-2022 (tavanet perfundimtare) dhe informacion mbi rekomandimet e Ministrise se Financave dhe Ekonomise gjate fazes se pare.

Per; MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISE
DREJTORIA E FINANCAVE VENDORE

Ne zbatim te Ligjit nr. 68/2017 "Per financat e vetëqeverisjes vendore", neni 36, si dhe te kalendarit buxhetor per pergatitjen e Programit Buxhetor Afatmesem, Bashkia Berat përgatiti fazën e pare te Programit Buxhetor Afatmesem 2020-2022. U miratua me Vendim te Keshillit Bashkiak nr. 50 date 19.03.2019 'Vleresimet afatmesme 2020-2022 te te ardhurave' si dhe me VKB nr. 51 date 19.03.2019 "Tavanet pergitore te PBA 2020-2022" U pergatit dhe u miratua drafti e pare ne Këshillin Bashkiak me Vendimin nr. 96 date 19.06.2019. Bashkia Berat ka depozituar prane MFE projektdokumentit e pare të Programit Buxhetor Afatmesëm, me shkresen nr 2980 prot. date 31.05.2019.

Ne zbatim te Udhezimit te Ministrit te financave dhe Ekonomise nr 23 date 30.07.2018, 'Per procedurat standarde te pergatitjes se programit buxhetor afatmesem te njesive te qeverisjes vendore', si dhe Udhezimit te Ministrit te Financave dhe Ekonomise nr. 7 date 27.02.2019 'Per pergatitjen e programit buxhetor afatmesem 2020-2022', u ngrit Grupi per Menaxhim Strategjik me Urdherin e Kryetarit te Bashkise nr. 207 Date 07.03.2019 si dhe EMP, u pergatit Udhezimi per pergatitjen e PBA 2020-2022 me nr. 1622 prot. date 25.03.2019 dhe iu vu ne dispozicion GMS dhe EMP.

Neni 37 i ligjit 'Per financat e vetëqeverisjes vendore', citon: Bazuar në vlerësimet dhe parashikimet afatmesme të përditësuara të të ardhurave dhe transfertave nga Buxheti i Shtetit, të përcaktuara në udhëzimin plotësues të përgatitjes së buxhetit vendor të Ministrisë së Financave, kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore përgatit dhe paraqet për miratim në këshillin e njësisë së vetëqeverisjes vendore tavanet përfundimtare të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm në nivel programi.

Ne kete konteks, per te finalizuar procesin dhe per te pergatituar draftin e rishikuar u pergatit Plani i Masave dhe Veprimet me nr. 3792/2 prot date 03.09.201, ku jane te percaktuar aktivitetet qe do te zhvillohen, afati, personat pergjegjes. U riformatua Grupi per Menaxhimin Strategjik me Urdherin e Kryetarit te Bashkise nr. 632 date 03.09.2019 si dhe EM.

Bashkia Berat sipas planit te hartuar zhvilloi degjesat publike me lagjet Nr.1.2.3 të Bashkisë Berat, Njësiti administrative Otlak , Sinje, Velabisht, Roshnik, me grupet e interesit dhe Komisionin Qytetar, duke kryer keto aktivitete:

Aktiviteti nr. 1 Organizimi i degjesave publike me komunitetin ne lagjet e qytetit dhe njesite administrative.

Aktiviteti nr. 2 Organizimi i degjesave publike me grupet e interesit; komisionin qytetar.

Aktiviteti nr. 3 Zhvillim i degjesave publike me komunitetin ne lagjet e qytetit , njesite administrative dhe grupet e ineteresit.

Aktiviteti nr. 4 Njoftimi per konsultimin publik te PBA 2020-2022

Aktiviteti nr. 5 Miratimi i dokumentit te rishikuar te PBA 2020-2022.

1. Pergatitja e materialit te rishikuar te Programit Buxhetor Afatmesem 2020 -2022 , Miratimi ne Keshillin Bashkiak

2. Dergimi i materialit ne Ministrine e Financave, brenda 15 shtatorit 2019.

Paraqesim me poshte problematikat te marra nga raporti permbledhes i pergatitur nga organizimi i degjesave ne cdo njesi administrative, lagjet e qytetit dhe grupet e ineteresit dhe komisioni qytetar:

(ne menyre te detajuar jane ne procesverbalet e takimeve, pjese perberese e ketij materiali.)

- Përmirësimin e infrastrukturës rrugore në akset dytësore të Lagjeve te qytetit.
- Përmirësimin e infrastrukturës rrugore në akset kryesore dhe dytësore Njësive Administrative;
- Përmirësimin e rrjetit të ujësjellës – kanalizimeve, duke vene ne rrugen e zgjidhjes furnizimin me uje te pishem ne fshatrat qe paraqesin problematika(Bilce, Duhanas, Starove, Velabisht, lagja Partizan,)
Përmirësimin e rrjetit të kanalizimeve, duke vene ne rrugen e zgjidhjes disiplinimin e ujrave te zeza ne fshatrat qe paraqesin problematika (Duhanas, Starove, Velabisht, etj.)
- Vënien në funksion të plotë të kanaleve kulluese dhe vaditëse në Njësiti Administrative; *Të hapen kanalet e dyta për vaditjen e tokave.*
- Furnizimin me ujë të pijshëm duke reduktuar kufizimet e duke përmirësuar rrjetin e shpërndarjes;
- Zgjidhjen e problemit të rrugëve në parcelat bujqësore;
- Krijimin e këndeve çlodhëse, argëtuese dhe sportive në zona të ndryshme të territorit të Bashkisë;
- Funksionimin e rrjetit të ndriçimit atje ku ky rrjet ekziston;

- Sistemimi dhe rrethimi i varrezave ne fshatin Veterrik,
- Përmirësimin e infrastrukturës në çerdhe, kopshte dhe qendra shëndetësore.
- Ngitjen e qendres shëndetësore ne Palikesht, Velcan, Osmenzeze,dhe vendosja ne eficence e ambulances ne fshatin Duhanas.

Propozimet e terhequra nga komuniteti dhe grupet e interesit u administruan nga GMS dhe sipas problematikave u percollen njesive shpenzuese te vartesis se bashkise per ti integruar ne programet perkatese buxhetore, sipas listimit te prioriteteve brenda mundesive financiare.

Me tej sipas afateve ligjore do te procedojme me pergatitjen e Dokumentit Final te PBA 2020-2022 dhe Plan Buxhetit te vitit 2020, te cilin do te shqyrtojme, diskutojme dhe miratojme ne Keshiilin Bashkiak brenda muajit dhjetor 2019.

Tavanet perfundimtare te PBA 2020-2022, te cilat nuk kane ndryshime me tavanet paraprake, jane pergatitur bazuar ne instrumentin e planifikimit te financiar dhe ndarjes ne nenfunsione sipas modelit te riderguar nga Ministria e Financave dhe Ekonomise.

Ministria e Financave me shkresen Nr.11597 ,date 18.06.2019 “Dergohen mendimet mbi PBA 2020-2022”, drafti I pare, ka dhene mendime te cilat po i rendisim se bashku me reflektimet dhe shpjegimet e administrates se bashkise:

I. Vështrim i Pergjitheshëm.

Nga vështrimi i Relacionit shpjegues te Programit Buxhetor Afatmesëm (PBA) 2020-2022 (shtojca 2) të Bashkisë Berat vërejm se, Programi Buxhetor Afatmesëm eshte nje dokument planifikimi afatmesem mbeshtetur ne planin strategjik te zhvillimit, per te bere te mundur realizimin e tij si dhe garantimin e nje zhvillimi te qendrueshem, me objektiv primar: permiresimin e cilesise se sherbimeve ndaj komunitetit.

Për cdo ndërhyrje Bashkia Berat ka zhvilluar një program buxhetor për të cilin ka identifikuar burimet që do të përdoren për të realizuar projektet. Të gjitha vendimet kryesore për financimin e politikave janë marrë duke analizuar arritjet e viteve te kaluara; vlerësimin real të burimeve; sigurimin e një zhvillimi te integruar tertorial te Bashkisë mbi bazë te Planit te Pergjithshëm Vendor dhe Strategjisë së Zhvillimit të Përgjithshëm.

MFE ka konstatuar se:

- Bashkia Berat ka respektuar standardet e percaktuara ne Udhezimin e Ministrit te Financave dhe Ekonomise nr 23 date 30.07.2018, ‘Per procedurat standarde te pergatitjes se programit buxhetor afatmesem te njesive te qeverisjes vendore’, si dhe Udhezimin e Ministrit te Financave dhe Ekonomise nr. 7 date 27.02.2019 ‘Per pergatitjen e programit buxhetor afatmesem 2020-2022’, ku percaktohen se pjese e dokumentit te hartimit te PBA jane ; pema e programit buxhetor, Relacioni shpjegues, Formatete outpute e IPF dhe treguesit e performances.
- Projektdokumenti i Programit Buxhetor Afatmesëm 2020-2022, të Bashkisë Berat është përgatitur ne Instrumentin e Planifikimit Financiar (FPT);
- Bashkia Berat ne relacioni shpjegues nuk ka pasqyruar zhvillimin e procesit te hartimit te project dokumentit te PBA –se, ka paraqitur orientimin afatgjate te bashkise te detjuar deri ne nivel

objektivash strategjik, si dhe ka pasquruar se procesi i hartimit të PBA –se bazohet në Planin e Përgjithshëm Vendor dhe planin e Përgjithshëm Kombëtar.

- Bashkia Berat ka depozituar pranë MFE projektin dokumentar të Programit Buxhetor Afatmesëm, me shkresën nr 2980 prot. datë 31.05.2019.
- Raportet e projektdokumentit të PBA-së, dërguar në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, janë sipas formateve të përcaktuara në udhëzimin plotësues;
- Bashkia Berat ka paraqitur relacionin shpjegues për procesin e përgatitjes të programit buxhetor afatmesëm, sipas Shtojcës 2, Programi Buxhetor Afatmesëm 2020-2022, të udhëzimit plotësues, por nuk janë planifikuar shpenzimet për çdo program sipas produkteve.

II. Mbi Programet Buxhetore të Bashkisë Berat.

Bashkia Berat ka parashikuar në PBA 2020-2022 zhvillimin e katër programeve buxhetore:

Organet ekzekutive dhe legjislativë, çështjet financiare dhe fiskale

Shërbimet e përgjithshme

Shërbimet policore

Shërbimet e mbrojtjes nga zjarri

Çështje të përgjithshme ekonomike, tregëtare dhe të punës

Bujqësia, pyjet, peshikim dhe gjuetia

Transporti

Industritë e tjera

Menaxhimi i ujërave të zeza

Mbrojtja e mjedisit

Zhvillimi i strehimit

Zhvillimi i komunitetit

Furnizimi me ujë

Shërbimet rekreative dhe sporti

Shërbimet kulturore

Arsimi bazë dhe parashkollor

Arsimi i mesëm

Sëmundjet dhe paafësia

Të moshuarit

Familje dhe fëmijët

Papunësia

Strehimi

Ndihma ekonomike

MFE ka vlerësuar angazhimin e Bashkisë Berat në përmirësimin e procesit të hartimit të Programit Buxhetor Afatmesëm, duke e kthyer PBA-në, në një mjet të realizimit të Strategjive të Zhvillimit. Mirepecaktimi i Qellimeve, Objektivave dhe Produkteve për çdo program buxhetor me tregues të matshëm si dhe planifikimi i shpenzimeve mbi bazë kosto për njësi produkti, bëjnë të mundur realizimin e Planit Strategjik të Zhvillimit.

Rekomandime:

1. EMP të parashikojnë produkte me terma të matshëm për çdo objektiv si dhe të planifikojnë shpenzime mbi bazë kosto për njësi produkti.

2. Ne dokumentin e PBA-se te pasqyrohet edhe procesi i hartimit te PBA-se mbi vendimet, udhezimet, urdherat e nxjerra gjate hartimit te PBA-se si dhe kalendarin e programit buxhetor afatmesem dhe buxhetit vjetor, mbi komentete mbi reapektimin e kalendarit.

III. Analiza, Komete dhe Rekomandime mbi parashikimet afatmesme te ardhurave buxhetore

Bashkia Berat në planifikimin e të ardhurave është mbështetur në realizimin faktik të të ardhurave të vitit 2017 dhe 2018. *Tabela: Burimet Buxhetor (Instrumenti i Planifikimit Financiar).*

Konstatojmë se, për parashikimin e të ardhurave afatmesme, janë mbështetur në realizimin faktik të të ardhurave të viteve paraardhëse, në ecurinë e trendit të dy viteve të fundit si dhe kanë parashikuar si faktorë ndikues në rritjen e të ardhurave; rritjes së bazës së taksapaguesve; forcimin e kapaciteteve administruuese dhe rritjen e numrit të taksapaguesve (baza e tatueshme), por jo me ndryshime në nivelet e taksave apo tarifave.

Në buxhetin e vitit 2019 te ardhurat dhe shpenzimet janë planifikuar të barabarte me parashikimin në PBA-në 2019-2021 , duke realizuar kështu një nga objektivat e PBA-së, që përgatitja e buxhetit vjetor është pjesë përbërëse e procesit të programit buxhetor afatmesëm, ku buxheti vjetor është i parë i këtij programi.

Tendenca e rritjes së të ardhurave:

Të ardhurat nga burimet e veta, per vitin 2020 janë planifikuar me një rritje prej 17.7 % ,nga pritshmeria e vitit 2019 (duke perjashtuar te ardhurat e trasheguara). Raporti I të ardhurave nga taksat dhe tarifat ndaj totalit të të ardhurave të përgjithshme parashikuar të jetë 33.3% në vitin 2020, 33.1% në vitin 2021; 32.6 % në vitin 2022.

Raporti i totalit te burimeve te veta ndaj totalit te te ardhurave te pergjitheshme jane parashikuar 48% ne vitin 2020, 47.7% ne vitin 2021 dhe 47% ne vitin 2022.

Referuar parashikimit të të ardhurave të veta, konstatohet se per cdo ze te te ardhurave eshte parashikuar nje rritje prej rreth 3% , si nga te ardhurat nga taksat dhe nga tarifat , megjithese bashkia ka evidentuar faktoret ndikues ne te ardhurat , te cilat kane ndikime te ndyshme ne zera dhe tregues te ndyshem te te ardhurave. Nuk kanë parashikuar taksa me ndikim negative në të ardhurat. Bashkia Berat ka planifikuar 2 taksa te perkohshme.

Të ardhurat nga transfertat e pakushtëzuar është planifikuar në vlerën e transfertës së përcaktuar në udhëzimin plotësues dhe Vendimin e Këshillit të Ministrave.

Rekomandim: 3. Parashikimi i të ardhurave nga “Taksat mbi ndërtesën” duhet të lidhet ngushtësisht me analizën e realizimit të Kadastrës Fiskale e cila ka nje ndikim të drejtpërdrejtë në realizimin e të ardhurave nga kjo taksë.

IV. Analiza, Komete dhe Rekomandime mbi parashikimet afatmesme te Shpenzimeve buxhetore

Në dokumentin e PBA-së të Bashkisë Berat, shpërndarja e burimeve është realizuar mbi bazë programi buxhetor dhe totali i tavaneve të shpenzimeve është brënda kontekstit të të ardhurave të parashikuara. Parashikimi buxhetor është i balancur. Jane parashikuar fond reserve dhe I kontigjences ne nivelin 1% te shpenzimeve te pergjitheshme.

Referuar Formatit “Parshikimi i shperndarjes së shpenzimeve sipas programeve për njësinë e vetëqeverisjes vendore”; Formatit “Investime afatmesme ne nivel programi”: Formatit “Kërkesat shtesë të programit buxhetor afatmesëm”, dhe Formatit “Shpenzime sipas funksionit”, të Instrumentit të Planifikimit Financiarë (IPF) vërejtme se :

Shpenzimet e përgjithshme per vitin 2020 jane planifikuar me nje rnie prej 17.% nga pritshemria e vitit 2019. per vitin 2021 me nje rritje prej 3.7%, ne krahasim me vitin 2020 dhe per vitin 2022 me nje rritje prej 4.4%, krahasuar me vitin 2021.

Raporti i shpenzimeve kapitale /shpenzimeve te përgjithshme jane parashikuar te jete 25.3% , ne vitin 2020, 26.4% ne vitin 2021, 27.4% ne vitin 2022.

Rritje e raportit të shpenzimeve kapitale në totalin e shpenzimeve të përgjithshme, politike qe con ne një zhvillim të qëndrueshëm të njësisë dhe rritjen e cilësisë së shërbimeve publike.

Fokusi i punes sone ne periudhen afatmesme 2020-2022 , konsiston ne permbushjen e qellimit kryesor: **Realizimin e investimeve te qendrueshme per ta kthyer Beratin ne nje destinacion te rendesishem turistik nderkombetar dhe zhvillimin e njesive administrative si pika te rendesishme te agrobiznesit dhe eko-turizmit.**

Ne dokument gjithashtu konstatohet se shpenzimet e personelit jane ne rnie, politke qe rrit efektivitetin e perdorimit te fondeve publike. Bashkia Berat nepermjet Shpenzimeve operative dhe te mirembajtjes synon permiresimin e cilesise se sherbimeve publike vendore, administrimin dhe mirembajtjen me te mire te ambjenteve mesimore, in frastrukturen rrugore, mirembajtjen e siperfaqeve te gjelbert, permiresimin e ndicimit publik.

Shpenzimet e personelit, operative dhe te mirembajtjes si dhe ato te investime jane pasqyruar ne Programet buxhetore qe planifikon te zhvilloj bashkia Berat per periudhen afatmeseme 2020-2022.

Rekomandim 4. Ekipet e Menaxhimit te Programit të hartojë kërkesat buxhetore bazuar në kostot për njësi të produktit, të cilat duhet të pasqyrohen në dokumentin e PBA- së. Grupi për Menaxhim Strategjik hartimin e taveve përfundimtare ta rishikojmë në kontekstin e vlerësimit të kostos të produkteve për çdo program buxhetor dhe prioriteteve strategjike të Bashkisë.

V. Disa nga Projektet prioritare të investimeve në periudhën afatmesme

1. Rehabilitimi i Skemës Ujitëse Mbreshtan.
2. Rikonstruksioni i rrugës ‘Shyqyri Lakra’.
3. KUZ Lapardha, Drobonik
4. Rehabilitimi i rrugës “Inerte” ,Njësia Administrative Otllak.
5. Vendosja e sistemit të kamerave ne bashki dhe institucine te vartesisë.
6. Mirëmbajtje kanale kulluese dhe ujitëse..
7. Asfaltim dhe shtrim rrugësh me beton,mirembajtje me cakull,vendosje tombino dhe mure mabjtëse ne Njësitë Administrative dhe lagjet e qytetit.
8. Ujesjellesi Velabisht, Palikesht.
9. Vijim i Rikonstruksion rrugesh të brëndshme ne lagjen 30-vjetori (ish Pjeshkorja).
10. Vijim i Rikonstruksionit te mureve te kalasë.

VI. Detyrimet e prapambetura

Rekomandim: 5. Shpenzimet e programit buxhetor, kur janë planifikuar për tu likuiduar detyrimet e papaguara dhe konstatuara, duhet të pasqyrohet në relacion vlera e detyrimeve, sipas klasifikimit ekonomik që është përfshirë në tavanin buxhetor të programit.

Rekomandim 6. Në bazë të Udhëzimit të Kryeministrit nr 1 datë 04.06.2014, "Për mënyrën e ekzekutimit të detyrimeve monetare të njësisë të qeverisjes së përgjithshmenë në llogari të Thesarit", shuma totale e detyrimeve për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë, bëhet pjesë e programit buxhetor dhe nëse gjatë vitit buxhetorë ka fonde të papërdorura, përpara mbylljes së vitit buxhetorë këto fonde mund të përdoren për aq sa është e mundur për shlyerjen e një pjese të vendimeve gjyqësore të formës së prerë, duke respektuar rradhën e paraqitjes.

VII. Rreziqet financiare dhe fiskale të bashkisë

Bashkia Berat ka parashikuar risqet financiare në realizimin e të ardhurave dhe shpenzimeve, si risk më të madh ka parashikuar mbledhjen e të ardhurave, paksim i numrit të bizneseve të reja. Paksim i numrit të familjeve të reja. Mosfunksionim të strukturave të kontrollit. Staf i patrajnuar për zbatimin e procedurave perkatese. Mosbashkerendim të punëve mes institucioneve, drejtorise dhe drejtorise se të Ardhurave. Ulje e numrit të fëmijëve për arsye të planifikimit familjarë. Paaftësia paguese e zotëruesve të banesave sociale, si dhe pronave të mara me qera dhe në shfrytëzim nga qytetarë dhe biznese.

Rekomandim: 7. Një vëmendje e vecant duhet ti kushtohet qëndrueshmërisë fiskale si një kërkesë për stabilitetin e bashkisë, dhe krahas njohjes së risqeve që përballen bashkia. Vëmendje duhet ti kushtohet dhe risqeve që vijnë nga plani I shlyerjes së detyrimeve të konstatuara dhe të papaguara nga marreveshjet e bashkëfinancimeve, si dhe ndryshimet buxhetor që kryhen gjatë viti.

VIII. Raporti i objektivave të synuara.

Roli kryesor i PBA-së është që të sigurojë që politika, objektivat dhe qëllimet të jenë të përcaktuara qartë dhe se programet dhe produktet e synuara do të arrijnë objektivat dhe qëllimet e politikës në një mënyrë që krijon një përdorim ekonomik eficient dhe efektiv të fondeve buxhetore në një proces vashdimësie. Qëllimet dhe Objektivat duhet të jenë në përputhje me dokumentet strategjike të zhvillimit të planifikuar dhe të planifikimit të politikave të njësisë së vetëqeverisjes vendore. **PBA është i vetmi instrument që bën të zbatueshem planin strategjik të zhvillimit të njësisë së vetëqeverisjes vendore, nëpërmjet planifikimit dhe menaxhimit të financave vendore për një periudhë trevjecare.**

Reflektimet e Bashkisë Berat në lidhje me 7 rekomandimet e MFE:

1. EMP të parashikojnë **produkte me term atë matshem** për çdo objektivi si dhe të planifikojnë shpenzime mbi baze të kostove për njësi produkti. Cdo njësi shpenzuese në hartimin e planit të detajuar të shpenzimeve, për selilin program për vitin 2020, (viti i parë i PBA) dhe për gjithë periudhën 3 vjecare, krahas Dekleratës së politikës së programit, që ka përfshirë:

- Qellimin e politikës së programit buxhetor.
- Objektivat e programit buxhetor, të matshëm.
- Aktivitetet që kryhen për realizimin e objektivave

Ka vijuar punën gjatë fazës së rishikuar të PBA 2020-2022 për përcaktimin e Produkteteve të programit në nivel treguesish, të matshëm, si dhe parashikimin e kostove për njësi produkti, si dhe treguesit e performancës, reflektuar edhe në raportin e monitorimit të buxhetit për 4- muajorin e dytë 2019.

2. Në dokumentin e PBA-së **te pasqyrohet edhe procesi i hartimit të PBA-së** mbi vendimet, udhëzimet, urdherat e nxjerra gjatë hartimit të PBA-së si dhe kalendarin e programit buxhetor afatmesëm dhe buxhetit vjetor, mbi komentete mbi rerapektimin e kalendarit.

Në fakt, Bashkia Berat administron gjithë dokumentet e procesit të hartimit të PBA, nuk i kemi përshkruar gjatë fazës së parë pasi të shtojca 2 nuk kishte rubrike të posaçme.

3. Parashikimi i të ardhurave nga **“Taksat mbi ndërtesën”** duhet të lidhet ngushtësisht me analizën e realizimit të Kadastrës Fiskale e cila ka një ndikim të drejtpërdrejtë në realizimin e të ardhurave nga kjo taksë. Do të jete në vëmendje për periudhën në vijim.

4. Ekipet e Menaxhimit të Programit të hartojë kërkesat buxhetore **bazuar në kostot për njësi të produktit**, të cilat duhet të pasqyrohen në dokumentin e PBA-së. Grupi për Menaxhim Strategjik hartimin e tavanëve përfundimtare ta rishikojmë në kontekstin e vlerësimit të kostos të produkteve për çdo program buxhetor dhe prioritetet strategjike të Bashkisë.

EMP dhe personat e angazhuar me përgatitjen e shpenzimeve buxhetore në nivel programi kanë marrë trajnin e duhur nga specialistët e financës së bashkisë, me qëllim që kërkesat buxhetore të jenë të bazuar në kostot për njësi të produktit, duke **kthyer procesin e përgatitjes së PBA-së në një proces gjithëpërfshirës.**

5. Shpenzimet e programit buxhetor, kur janë planifikuar për tu likuiduar **detyrimet e papaguara** dhe konstatuara, duhet të pasqyrohet në relacion vlera e detyrimeve, sipas klasifikimit ekonomik që është përfshirë në tavanin buxhetor të programit.

Do të jete pjesë e relacionit gjatë hartimit të Buxhetit vjetor 2020 dhe PBA Përfundimtare 2020-2022.

6. Në bazë të Udhëzimit të Kryeministrit nr 1 datë 04.06.2014, “Për mënyrën e ekzekutimit të detyrimeve monetare të njësisë të qeverisjes së përgjithshme në llogari të Thesarit”, **shuma totale e detyrimeve për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë, bëhet pjesë e programit buxhetor** dhe nëse gjatë vitit buxhetorë ka fonde të papërdorura, përpara mbylljes së vitit buxhetorë këto fonde mund të përdoren për aq sa është e mundur për shlyerjen e një pjesë të vendimeve gjyqësore të formës së prerë, duke respektuar rradhën e paraqitjes. Do të vijoj të jete në qendër të vëmendjes sonë, jo vetëm në përgatitjen e dokumentit të PBA Përfundimtare 2020-2022, por dhe gjatë zbatimit të buxhetit 2019.

7. Një vëmendje e veçantë duhet të kushtohet **qëndrueshmërisë fiskale** si një kërkesë për stabilitetin e bashkisë, dhe krahas njohjes së risqeve që përballen bashkia.

Vëmendje do të kushtojmë edhe risqeve që vijnë nga plani I shlyerjes së detyrimeve të konstatuara dhe të papaguara nga marreveshjet e bashkëfinancimeve, si dhe ndryshimet buxhetor që kryhen gjatë vitit.

Ne zbatim te Ligjit nr. 68/2017 "Per financat e vetëqeverisjes vendore", neni 38 , *procsverbalet e degjesave publike si dhe lista e pjesmarreseve jane pjese e dokumentave te pergatitjes dhe miratimit te PBA 2020-2022. (Fotokopjet bashkelidhur)*


Materiali do te shqyrtohet ne mbedhjen e keshillit bashkiak te muajit shtator.

Tavanet Perfundimtare te PBA 2020-2022, pergatitur bazuar ne instrumentin e planifikimit te financiar dhe ndarjes ne nenfunsione sipas modelit te derguar nga Ministria e Financave dhe Ekonomise. (te cilat po jua percjellim elektronikisht ne adresat e cituar me UMFE), nuk kane ndryshime nga tavanet pergtatitore miratuar me VKB nr.51 date 19.03.2019.

Faleminderit per bashkepunimin!

KRYETARI I BASHKISË (NA)

Ervin DEMO



DREJTORE FINANCES (NZ)

Luiza BAZAJ

